



Opština Novo Brdo
Komuna e Novobërdës - Municipality of Novo Brdo

Bazuar në nenin 8, paragrafi 3, pika 2 e Rregullores MF-Br-04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat për financimin publik të OJQ-ve, Komuna e Novobërdës më 07.11.2022, njofton si në vijim:

**Thirrje publike për përzgjedhjen e një (1) përfaqësuesi të Komisionit
Vlerësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm**

1. Ftohen të interesuarit dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare (OJQ) të paraqesin aplikime për zgjedhjen e një anëtari të Komisionit për vlerësimin e projekt propozimeve të paraqitura në Thirrjen Publike për Mbështetje Financiare Publike për financimin e projekteve të OJQ-ve/ programe në fushën e zhvillimit të turizmit.
2. Kandidatët duhet të kenë përvojë disavjeçare në punë me organizata joqeveritare ose agjenci të pavarura dhe të mos kenë qenë të dënuar për vepra penale.
3. Kandidati i përzgjedhur kryen detyrën e anëtarit të Komisionit Vlerësues pa kompensim, në përputhje me përcaktimet e Rregullores MF-Nr.04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
4. Afati i fundit për paraqitjen e aplikacioneve është data 08.11.2022 deri më 18.11.2022.
5. Së bashku me Aplikacionin është e nevojshme të paraqisni një CV të shkurtër me të dhëna për përvojën e punës.
6. Aplikimet mund të dorëzohen me postë ose personalisht, në adresën: Komuna Novobërdë, nema ulice bb, 16000 Novobërdë.
7. Të gjitha pyetjet në lidhje me ftesën publike mund t'i sqaroni vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar një e-mail në adresën: info.noberde@rks-gov.net.



Kryetari i Komunës

Saša Milošević